

URDHËR
Nr. 9, datë 13.2.2013

**PËR REVOKIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT TË FINANCAVE NR. 6, DATË 25.11.2005
“PËR SEKUESTRIMIN E ASETETEVE TË SHTETASIT JORDANEZ ABDUL LATIF SALEH, I
NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF A.A.SALEH, B) ABDYL LATIF SALEH, C) DR. ABD
AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A.SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-LATIF SALIH,
F) ABU AMIR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr. 8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 7.2.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit””, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 6, datë 25.11.2005 “Për sekuestrimin e asetëve të shtetasit jordanëz Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A.Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd Al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A.Saleh Abu Hussein, e) Abd Al-Latif Salih, f) Abu Amir” të Ministrit të Financave, të ndryshuar me urdhrat nr. 22, datë 13.6.2006 dhe nr. 28, datë 5.7.2006.

2. Ky revokim përfshin të gjitha fondet, llogaritë, asetet, pasuritë e paluajtshme, trojet, investimet në shoqëri tregtare dhe mjetet financiare në emër të shtetasit Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A.Saleh; b) Abdyl Latif Saleh; c) Dr. Abd Al-Latif Saleh; d) Abdyl Latif A.A.Saleh Abu Hussein; e) Abd Al-Latif Salih; f) Abu Amir”, të sekuestruara me urdhrat e mësipërm.

3. Për dorëzimin e pasurive të revokuara me këtë urdhër, të ngrihet një grup pune në përbërje të të cilit të ketë një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

4. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për kthimin e pasurive të identifikuara dhe të marra në dorëzim, si dhe të ardhurave të siguruar nga administrimi i tyre, pasi t’i zbriten shpenzimet e lejuara.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode